



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK**

VENDIM

Nr. 19, datë 09.05.2019

MBI

**“MIRATIMIN PARAPRAK, PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË
STUDIMIT PEDAGOGJI MUZIKORE, BASTUB DHE MËSUESI, KITARË DHE
MËSUESI DHE FIZARMONIKË DHE MËSUESI, CIKLI I DYTË MASTER
PROFESIONAL, NË FAKULTETIN E MUZIKËS TË UNIVERSITETIT TË
ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 31, datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë” dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Fakulteti Muzikës, pasi e diskutoi me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin paraparak, për riorganizimin e programeve të studimit Pedagogji Muzikore, Bastub dhe Mësuesi, Kitarë dhe Mësuesi dhe Fizarmonikë dhe Mësuesi, cikli i dytë Master Profesional, në Fakultetin e Muzikës të Universitetit të Arteve, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim ti dërgohet Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve për miratim paraparak dhe më pas të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit të Arsimit Sportit dhe Rinisë për miratim përfundimtar.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

